



Datë: 29.04.2025
Numër Protokolli: 2879/2025

A.nr.401/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.401/2025 të datës 28.02.2025, të parashtruar nga ankuesi B.H., kundër organit të punësimit/Ministra e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 29.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.401/2025, e datës 28.02.2025, e parashtruar nga ankuesi B.H.
- II. Pala udhëzohet që të drejtën ta kërkojë në kontestin juridiko-civil.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.H. (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 28.02.2025 fizikisht ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/Nr.25, të datës 07.02.2025, të ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 20.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje referuar MINT), ndërsa kjo e fundit me datë 21.03.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së Punës për Periudhë të Pacaktuar me numër protokolli 01/272/2021 të datës 12.02.2021 mban pozitën *Udhëheqës i Departamentit* në Doganën e Kosovës. Tutje sipas provave të lëndës, respektivisht Vendimit me Nr.

07/60 të datës 27.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është formuar Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike me përbërje prej dhjetë anëtarësh ku ankuesi është caktuar anëtar i këtij komisioni, ndërsa sipas Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është aprovuar kërkesa e Departament për Kontrollin e Tregut të Mallrave Strategjike për plotësimin e Vendimit me Nr. 07/60 të datës 27.01.2021, gjegjësisht është plotësuar pikë 1.3 dhe 1.4 e vendimit ashtu që B.K./MM dhe N.Z./MMA zëvendësohen me Major M.TH./MM dhe A.Ç./MM, kurse me Vendimit me Nr. 08/121 të datës 25.01.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është aprovuar kërkesa e Departamentit për Kontrollin e Tregut të Mallrave Strategjike për plotësimin e Vendimit me Nr. 11/68 të datës 23.03.2022, gjegjësisht është plotësuar pika 2 dhe pika 3 ashtu që M.TH./MM është zëvendësuar nga Nënkolonel F.E., anëtar dhe Sh.M./MPJD është zëvendësuar nga E.P./MPJD anëtare.

Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, ka kërkuar nga MINT, kompensimin për punë shtesë për pjesëmarrjen në këtë komision, mirëpo Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Funkcion Shtesë, sipas Rekomandimit të datës 28.01.2025, ka njoftuar se kompensimi nuk mund të realizohet sepse nuk janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë, ndërsa u.d Sekretarja e Përgjithshme e MINT më datë 07.02.2025 ka nxjerr Vendim Ref.02/Nr.25, me të cilin ka refuzuar kërkesën për kompensim për punë shtesë të Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, me arsyetimin se lidhur me procedurën e miratimit nuk plotësohet neni 6 i Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë sepse: Institucioni që e themelon parasheh të drejtën për kompensim të anëtarëve të bordit apo komisionit dhe e përcjell tek Njësia përkatës për ekzekutim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/Nr.25, të datës 07.02.2025, të ud. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë sepse është bazuar në një rekomandim të Komisionit për funksion shtesë i cili në mënyrë të gabueshme ka interpretuar nenin 6 të kësaj rregulloreje. Sek komisioni i ka plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat ligjore kjo nuk është fare kontestuese por as nuk duhet të jetë kontestues kompensimi ngase sipas vendimeve për formimin e Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike ka qenë MINT që është obliguar të zbatoj dhe duhet të zbatoj vendimet e Kryeministrit. Kërkon nga që ankesa të aprovohet dhe të kompensimin për funksion shtesë në mënyrë retroaktive nga muaj shkurt 2023 deri në muajin shkurt 2025.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të kompetencës lëndore për vendosje lidhur me këtë çështje ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 3 paragrafi 2, ku përcaktohet: 2. *Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim: 2.1. gjyqtaret/ët dhe prokuroret/ët; 2.2. personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse; 2.3. të punësuarat/it në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë; 2.4. të punësuarat/it në Policinë e Kosovës; 2.5. të punësuarat/it në Inspektoratin Policor të Kosovës; 2.6. të punësuarat/it në Doganën e Kosovës; 2.7. të punësuarat/it në Njësinë për Inteligjencë Financiare; 2.8. drejtoresh/in apo anëtarët/ët e organit drejtues kolegjal të agjencive rregullatore; 2.9. personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të komunës.*

Andaj, referuar përcaktimi ligjor si më sipër dhe duke qenë së ankuesi sipas Kontratës së Punës për Periudhë të Pacaktuar me numër protokolli 01/273/2021 të datës 12.02.2021, e ka të themeluar marrëdhënie të punës në kuadër të Doganave të Kosovës sipas Ligjit të punës, atëherë, Kolegji mbi këtë fakt e duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është

kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.401/2025 të datës 28.02.2025, të parashtruar nga ankuesi, sepse i njëjti ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil dhe marrëdhënia e tij e punës është përjashtuar nga Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejte kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore të Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 78 dhe 79 ka përcaktuar: Neni 78, paragrafi 1 " 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS *Lënda me numër A.nr.401/2025*

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.H.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.